

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
Programi:	Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve
Titulli i lëndës:	Kalkulimi i Kostos dhe Vendosija e Çmimit
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi:	4
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Ismail Mehmeti
Detajet kontaktuese:	ismajl.mehmeti@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës	
	Lëndë Kalkulimi i Kostos dhe Vendosija e Cmimit fokusohet në rolin e kostove për afarizmin e bizneseve, literatura shkencore përfshinë tema – Metodatat për llogaritje të kostove, Llogaritja – alokimi i kostove, Sjellja e kostove sipas aktivitetit në kompani, Struktura e kostove, Identifikimi i Pragut të rrezikur në kompani, Analiza Kosto Vëllim Fitim (KVF), Koncepti menaxhimi i kostove, Kostot e produktit, Kontabiliteti dhe kosto, Kosto – vendimmarrja në kompani, Vendosija e çmimit, Përfshirja e kostove dhe çmimi, Metodatat – përlllogaritja e çmimit, si dhe tema tjera ndërlidhur me lënden.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i modulit është që studentët të zhvillohen si lider - profesionist të fushës, të cilët janë në gjendje të realizojnë kalkulim të koston të produktit për vendosje të çmimit, në këtë kontekst ata të jenë në gjendje të identifikojnë rëndësinë e përlllogaritjes së koston të produktit që ndikon pozitivisht në afarizmin biznesor të kompanisë, duke përfituar aftësi, shkathtësi dhe njohuri të nevojshme personale për zhvillim në karrierë. Ky modul – ndër të tjera - do t'iu mundësojë studentëve përfitimin e njohurive për disa metoda që përdoren për caktimin/përlllogaritjen e çmimeve duke i përfshirë kostot në kompani.
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<i>Pas përfundimit të këtij moduli, studenti do të jetë në gjendje të:</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë menaxhimin dhe klasifikimin e kostove; • Njohë dhe kuptojë kalkulimin e kostos së prodhimit dhe të përcaktojnë pragun e rrezikut; • Përcaktojë performancën e biznesit përmes sistemit të përlogaritjes së kostove; • Përshtatë dhe kuptojë kostot relevante dhe procesin e marrjes së vendimeve në afat të shkurtër; • Përcaktojë kostot standarde dhe shmangiet nga këto kosto për formimin e çmimit. • Kuptojë dhe dinë për metodat për formimin e çmimit të produktit.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet detyra	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësuesin - konsultimet			
Ushtrime në terren			
Kolloquium - seminar	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			35
Përgatitja përfundimtare në provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet etj	1	4	4
Totali			100

Metodologjia e mësimit (dhe mësuesit)	Në ligjërata do të dëgjohet opinioni i studentëve për literaturën që do të përdoret, për mënyrën e organizimit të ligjërës dhe cila do të jetë me studentin në qendër dhe koordinuar për diskutime interaktive lidhur me temat dhe detyrat e shtjelluara gjatë ligjërës, fokusi të shembujt nga praktika biznesore që ndërlidhet me përshirje të kostos në vendosje të çmimit, gjatë periudhës semestrale synohet realizimi i vizitës praktike-grupore me studentë të nje biznes, prezantimi
--	--

	nga studentët i projekteve dhe detyrave te parapara ne modulin e lëndës.
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	<p>Vlerësimi dhe forma e ndërtimit të notës për studentet do të mbështetet në tre aktivitetet e mëposhtme:</p> <p>1. Aktiviteti dhe angazhimi në mësim - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme,</p> <p>Aktiviteti ne mësim - nënkupton që studenti te jetë aktive dhe i përfshirë ne diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema te reja qe janë te ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim te nxitjes se debatit gjate ligjëratave.</p> <p>Angazhimi - nënkupton qe studenti ti kryej dhe prezantoj detyrat qe caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese.</p> <p>2. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme,</p> <p>Brenda semestrit studenti (mund te jete një grup i studenteve - jo me shume se 3 studente) duhet te përgatit një detyre, projekt/ punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim/detyre duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim.</p> <p>Detyra/tema e punimit mund te propozohet nga profesori dhe nga studenti - detyra/tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet te jetë ne korrelacion te plot me lëndën.</p> <p>3. Testi i provimit final, vlerësohet me 80 pikë nga 100 pikët e mundshme,</p> <p>Brenda semestrit parashihet te mbahen dy Teste (2 x 40 pikë), testi i parë ne javën e 7 dhe testi i dyte ne fund te ligjëratave, studenti e kalon testin e parë nëse ka min 20 pikë, pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë mund t'i nënshtrohet testit të dytë, studenti ka te drejt ti nënshtrohet provimit final - me goje ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit te provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës, provimi organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit.</p> <p>Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria,</p>

	<p>aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies së parapare për materialin e lëndës së ligjësuar.</p> <p>Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës, • pyetje dhe detyra me shkrim për të cilat vetë studenti duhet të jetë në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe zgjidhje/vlerësim të problemit. <p>Studenti pasi i nënshtrohet provimit (testeve), do të ndërtojë notën përfundimtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • max 10 pikë - aktiviteti dhe angazhimi në mësim, • max 10 pikë- hartimi dhe prezantimi i detyres, projektit/punimi seminarik, • max 80 pikë - provimi final (ose nga dy testet), <p>Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga të gjitha kriteret e vlerësimit,</p>
Mjetet e konkretizimit - TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% Teori, 40% Ushtrime,
Literatura	
Literatura bazë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Skender Ahmeti - " Kontabiliteti i menaxhmentit", Prishtinë, 2018 2. Ismail Mehmeti - "Kalkulimi i Kostos dhe Vendosija e Çmimit", Ferizaj 2023 (Ligjëratë e autorizuar), 3. Hidajete Shehu, Xhelal Mziu dhe Belinda Xarba - "Analiza e Kostove", 2018, Shtëpia Botuese "DitaPrint", Tirane,

Literatura shtesë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shefket Jakupi – “Kontabiliteti i Kostos” – Prishtine 2014, 2. Robert Libby, Patricia A. Libby, Frank Hodge (Redaktuar Sotiraq Dhamo) – “The financial accounting” (eng) “Kontabiliteti Financiar” (shq), 2020, Tirane, 3. Rrustem Asllanaj, “Kontabiliteti Financiar”, Prishtinë 2013, 4. Skender Ahmeti – “Analiza e pasqyrave Financiare”, Prishtine 2020,
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	<p>Prezantimi – njoftimi i studentëve me syllabusin e lëndës, Menaxhimi i kostos, elementet e menaxhimit te kostos, Është ligjëratë hyrëse, studentet njoftohen me plan-programin e lëndes, zgjedhin grupet punuese për hartim te detyrave projekt/punimit, fillohet me ligjëratë gjithëpërfshirëse për koston dhe menaxhimin e kostos, studentët njoftohen me elementet e menaxhimit te kostove, me planin dhe raportimin e kostove,</p> <p>Rezultati i pritur nr. 1.</p>
Java e dytë	<p>Kostot nocioni i kostove, Kostot e produktit Ne këtë ligjëratë studentët do te njoftohen me qëllimin dhe definimin e kostove, me kostot sipas nevojave te brendshme te kompanisë, me kostot e produktit – ndarjen e kostove ne materialin dirket, punen direkte dhe kosto indirekte, do te diskutohet me student për detyrat dhe projektet qe ata duhet ti kryejn gjate aktivitetit mesimor semestral,</p> <p>Rezultati i pritur nr. 1.</p>
Java e tretë	<p>Struktura dhe klasifikimi i kostove, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime dhe ligjerata, studentët do te njoftohen me strukturen e kostove ne kompani varësisht nga aktiviteti – kostot e kontrolluara, te pakontrolluara, me kostot e fundosura, oportune, me kostot direkte dhe indirekte, do te ketë diskutime grupore me studentët për detyra dhe projekte/punime të studentëve,</p>

		Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2.
	Java e katërt	<p>Pragu i rrezikut ne kompani, diskutim grupor me studente, Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutim me studentët për materialin e ligjeratave paraprake, studentët do te njoftohen me identifikimin e kostove dhe sasis se nevojshem te prodhimit qe e përcaktojnë prapun e rrezikut në kompani, metodat apo qasja e te ardhures operative dhe qasja sipas marzhes se kontributit, studentët do te prezantojne (diskutim grupor) për aktivitet e tyre punuese, nga studentet do te kërkohet mendim për ecurinë e ligjëratave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim.</p> <p>Rezultati i pritur nr. 3.</p>
	Java e pestë	<p>Analiza Kosto Vëllim Fitim (KVF), diskutim interaktiv me studentë, Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutime grupore me studentë – përsëritje, do te njoftohen studentët me rolin qe e ka analiza e Kostos Vëllimit dhe Fitimit per afarizmin e biznesit, fokus ne ndryshimin e kostos fikse, variable dhe ne ndryshimin e çmimit te shitjes, diskutime grupore me studentë te cilët do te prezantojnë punimet e tyre,</p> <p>Rezultati i pritur nr.3.</p>
	Java e gjashtë	<p>Llogaritja e kostove - Metodat, aktivitet interaktiv me studente për punime, Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me Metodat për llogaritjen e kostove, fokusi te metoda FIFO, LIFO dhe ACM, studentet do te prezantojnë punimet dhe do te organizohet diskutim interaktive,</p> <p>Rezultati i pritur nr. 4,</p>
	Java e shtatë	<p>Diskusime interaktive për materialin e lëndës se përpunuar - Testi i parë me shkrim,</p> <p>Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.</p>
	Java e tetë	<p>Kontabiliteti dhe kostot, diskutim grupor (luajtje te rolit nga studentet nderlidhur me temen) Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutim interaktive me</p>

	<p>fokus përsëritje te ligjëratës paraprahe, studentët do te njoftohen me rolin e kontabilitetit ne kompani, ata do te njoftohen me kontabilitetin financiar duke perfshire pasqyrat financiare – Bilanci i Gjendjes, Suksesit, Ekuiteti i pronarit, Rrjedha e parasë, studentët do te prezantojnë punimet dhe do te ketë diskutim grupor, nga studentet do te kërkohet mendim për ecurinë e ligjëratave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim.</p> <p>Rezultati i pritur nr. 5.</p>
Java e nëntë	<p>Kontabiliteti menaxherial, i kostos dhe i përgjegjësis, aktivitet grupor me studentë (kuiz garues studentor ndërlidhur me temat e ligjeruara), Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me rendesin e kontabilitetit menaxherial, te kostos dhe atij te pergjegjesis, cilat janë detyrat në secilin nga këto lloje te kontabilitetit, do te kete aktivitet grupor me studentë,</p> <p>Rezultati i pritur nr. 5,</p>
Java e dhjetë	<p>Llogaritja – Alokimi i kostove, Në këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me rëndësin e përlllogaritjes se kostove dhe mënyrën e shpërndarjes dhe alokimit te kostove te produktet e prodhuara duke përdorur shkallën e alokimit dhe koston e alokuar, do të ketë diktutime grupore – prezantime nga studentët të projekteve të tyre te para-caktuara.</p> <p>Rezultati i pritur nr. 5 dhe 6,</p>
Java e njëmbëdhjetë	<p>Kostot vendimamarrja ne kompani, punë grupore me studentë, Në këtë ligjëratë do te ketë ushtrime- përsëritje, studentët do te njoftohen me rëndësin e analizës se kostove për vendimamrre te drejtë ne komapni, fokus do te jetë Kosto Vellimi Fitimi, prezentim dhe diskutim grupor me studentë,</p> <p>Rezultati i pritur nr. 5 dhe 6,</p>
Java e dymbëdhjetë	<p>Vendosja e çmimit - kuptimi, punë grupore studentore, Në këtë ligjëratë do te ketë përsëritje – ushtrime ndërlidhur me temat e ligjeruara, studentët do te</p>

	<p>njoftohen me rëndësinë e Çmimit për aktivitetin afarist të një kompanie, çka mund të jetë çmimi dhe cilat komponente duhet të analizohen me rastin e vendosjes së çmimit, diskutime interaktive me studentët për prezantimet e detyrave/projekteve hulumtuese,</p> <p>Rezultati i prituri nr. 6,</p>
Java e trembëdhjetë	<p>Çmimi përfshirja e kostos, diskutim interaktiv me studentët, Në këtë ligjërate do të ketë përsëritje, studentët do të njoftohen me Kostot që duhet të përlllogariten me rastin e vendosjes së çmimit, duke u fokusuar në koston totale të produktit, koston e produktit dhe në koston variabile të produktit, diskutim interaktiv studentor - do të shqyrtohet mundësia për të organizuar një vizitë pune në një organizatë që merret me fushën biznesore,</p> <p>Rezultati i prituri nr. 6,</p>
Java e katërbëdhjetë	<p>Përlllogaritja e çmimit - metodat, diskutim grupor me studentët, përsëritje e materialit të përpunuar, Në këtë ligjërate do të ketë përsëritje të temave të ligjëruara, studentët do të njoftohen me disa nga metodat me të shpeshta për përlllogaritjen e çmimit në kompani, metoda e kosto + marzhit, metoda e pikës kritike, metoda e kthimit nga investimi, do të ketë diskutim grupor me studentët për prezantimet e studenteve.</p> <p>Rezultati i prituri nr. 6 dhe 7.</p>
Java e pesëmbëdhjetë	<p>Metodat e llogaritjes së çmimit - detyra - diskutime interaktive për materialin e lëndës së përpunuar - Testi i dytë me shkrim,</p> <p>Rezultatet e pritura nr. 5, 6 dhe 7</p>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fikën ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e</p>	

integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga mësimdhënësi.